



Pranuar / Doretuar Priljeno/Prudato Received/Delivery	17-08-2023	3	viti god. year
Organ/Njësia Organ/Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUPSHTICE	5707/2023		117



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.918/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari-Anëtarë, me Çlirim Zeka Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtës, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.918/2023 të datës 05.07.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted] të cilën me autorizim e përfaqëson Avokati [redacted] kundër organit të punësimit

Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës, në çështjen juridike "Kompensim Material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 17.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon Procedimi Administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.918/2023 të datës 05.07.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] i punësuar në pozitën "Zyrtar i Operimeve për Helikopter" në kuadër të Departamentit të Sigurisë së Fluturimeve në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës sipas Akt Emërimit të datës 01.01.2013, ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5030/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor kundër përgjigjes nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës të datës 14.06.2023 në lidhje me kompensimin e diferencës së pagës së tij.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.07.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës, ndërsa Këshilli më datë 27.07.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me nr.protokolli 5030/2023 të datës 05.07.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për kompensim me numër protokoll 2023/BNJ/200 të datës 06.06.2023; Pasqyrën e llogarisë bankare të ankuesit S.A të datës 07.03.2023 të lëshuar nga Procredit Bank; Kërkesë për pagesë retroaktive/Formulari i të dhënave për listën e pagave të lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës për S.A lidhur me Ekzekutimin e Vendimit të KPMSHCK-së Nr.1247/2022 për kompenzimin e diferencës së pagës për muajin shkurt 2020; Kërkesë për pagesë retroaktive/Formulari i të dhënave për listën e pagave të lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës për S.A lidhur me Ekzekutimin e Vendimit të KPMSHCK-së Nr.1247/2022 për kompenzimin e diferencës së pagës për muajin janar 2020; Kërkesë për pagesë retroaktive/Formulari i të dhënave për listën e pagave të lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës për S.A lidhur me Ekzekutimin e Vendimit të KPMSHCK-së Nr.1247/2022 për kompenzimin e diferencës së pagës për muajin dhjetor 2019; Kërkesë për pagesë retroaktive/Formulari i të dhënave për listën e pagave të lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës për S.A lidhur me Ekzekutimin e Vendimit të KPMSHCK-së Nr.1247/2022 për kompenzimin e diferencës së pagës për muajin nëntor 2019; Kërkesë për pagesë retroaktive/Formulari i të dhënave për listën e pagave të lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës për S.A lidhur me Ekzekutimin e Vendimit të KPMSHCK-së Nr.1247/2022 për kompenzimin e diferencës së pagës për muajin tetor 2019; Kërkesë për pagesë retroaktive/Formulari i të dhënave për listën e pagave të lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës për S.A lidhur me Ekzekutimin e Vendimit të KPMSHCK-së Nr.1247/2022 për kompenzimin e diferencës së pagës për muajin shtator 2019; Kërkesë për pagesë retroaktive/Formulari i të dhënave për listën e pagave të lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës për S.A lidhur me Ekzekutimin e Vendimit të KPMSHCK-së Nr.1247/2022 për kompenzimin e diferencës së pagës për muajin gusht 2019; Kërkesë për pagesë retroaktive/Formulari i të dhënave për listën e pagave të lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës për S.A lidhur me Ekzekutimin e Vendimit të KPMSHCK-së Nr.1247/2022 për kompenzimin e diferencës së pagës për muajin korrik 2019; Kërkesë për pagesë retroaktive/Formulari i të dhënave për listën e pagave të lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës për S.A lidhur me Ekzekutimin e Vendimit të KPMSHCK-së Nr.1247/2022 për kompenzimin e diferencës së pagës për muajin qershor 2019; Kërkesë për pagesë retroaktive/Formulari i të dhënave për listën e pagave të lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës për S.A lidhur me Ekzekutimin e Vendimit të KPMSHCK-së Nr.1247/2022 për kompenzimin e diferencës së pagës për muajin maj 2019; Kërkesë për pagesë retroaktive/Formulari i të dhënave për listën e pagave të lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës për S.A lidhur me Ekzekutimin e Vendimit të KPMSHCK-së Nr.1247/2022 për kompenzimin e diferencës së pagës për muajin prill 2019; Kërkesë për pagesë retroaktive/Formulari i të dhënave për listën e pagave të lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës për S.A lidhur me Ekzekutimin e Vendimit të KPMSHCK-së Nr.1247/2022 për kompenzimin e diferencës së pagës për muajin mars 2019;

Kërkesë për pagesë retroaktive/Formulari i të dhënave për listën e pagave të lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës për S.A lidhur me Ekzekutimin e Vendimit të KPMSHCK-së Nr.1247/2022 për kompenzimin e diferencës së pagës për muajin shtator 2022; Kërkesë për pagesë retroaktive/Formulari i të dhënave për listën e pagave të lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës për S.A lidhur me Ekzekutimin e Vendimit të KPMSHCK-së Nr.1247/2022 për kompenzimin e diferencës së pagës për muajin gusht 2022; Kërkesë për pagesë retroaktive/Formulari i të dhënave për listën e pagave të lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës për S.A lidhur me Ekzekutimin e Vendimit të KPMSHCK-së Nr.1247/2022 për kompenzimin e diferencës së pagës për muajin korrik 2022; Kërkesë për pagesë retroaktive/Formulari i të dhënave për listën e pagave të lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës për S.A lidhur me Ekzekutimin e Vendimit të KPMSHCK-së Nr.1247/2022 për kompenzimin e diferencës së pagës për muajin qershor 2022; Kërkesë për pagesë retroaktive/Formulari i të dhënave për listën e pagave të lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës për S.A lidhur me Ekzekutimin e Vendimit të KPMSHCK-së Nr.1247/2022 për kompenzimin e diferencës së pagës për muajin maj 2022; Kërkesë për pagesë retroaktive/Formulari i të dhënave për listën e pagave të lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës për S.A lidhur me Ekzekutimin e Vendimit të KPMSHCK-së Nr.1247/2022 për kompenzimin e diferencës së pagës për muajin prill 2022; Kërkesë për pagesë retroaktive/Formulari i të dhënave për listën e pagave të lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës për S.A lidhur me Ekzekutimin e Vendimit të KPMSHCK-së Nr.1247/2022 për kompenzimin e diferencës së pagës për muajin mars 2022; Kërkesë për pagesë retroaktive/Formulari i të dhënave për listën e pagave të lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës për S.A lidhur me Ekzekutimin e Vendimit të KPMSHCK-së Nr.1247/2022 për kompenzimin e diferencës së pagës për muajin shkurt 2022; Kërkesën për pagesë retroaktive/Formulari i të dhënave për listën e pagave të lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës për S.A lidhur me Ekzekutimin e Vendimit të KPMSHCK-së Nr.1247/2022 për kompenzimin e diferencës së pagës për muajin janar 2022; Kërkesë për pagesë retroaktive/Formulari i të dhënave për listën e pagave të lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës për S.A lidhur me Ekzekutimin e Vendimit të KPMSHCK-së Nr.1247/2022 për kompenzimin e diferencës së pagës për muajin dhjetor 2021; Vendim i KPMSCHK me numër protokolli 1878/2023 i datës 20.02.2023; Kërkesë për pagesë retroaktive/Formulari i të dhënave për listën e pagave të lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës për S.A lidhur me Ekzekutimin e Vendimit të KPMSHCK-së Nr.1247/2022 për kompenzimin e diferencës së pagës nga muaji datë 19.12.2018 deri me datë 30.05.2023; Aktvendim me numër A.nr.776/2023 i datës 05.05.2023 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; E-mailin e datës 13.06.2023 të dërguar nga av.H.S për S.S; E-mailin e datës 12.06.2023 të dërguar nga S.S për av.H.S; Kredencialet e Inspektorit S.A nga AAC; Autorizim i datës 02.06.2023 të S.A për av.H.S; Vendim me numër reference 27/2023 i datës 15.05.2023 i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës; Totali i pagesës për 53 muaj e 9 ditë; Lista e pagës së S.S; Diferenca e pagës-AAC 4-AAC-3 e vitit 2018; Diferenca e pagës-AAC 4-AAC-3 e vitit 2019; Diferenca e pagës-AAC 4-AAC-3 e vitit 2022; Diferenca e pagës-AAC 4-AAC-3 e vitit 2021; Diferenca e pagës-AAC 4-AAC-3 e vitit 2023; Diferenca e pagës-AAC 4-AAC-3 e vitit 2020; E-mailin e datës 05.07.2023 së bashku me shkresat e bashkangjitura të dërguar nga S.A për H.S. me me korrespondim prej 1-11 faqe; E-mailin e datës 05.07.2023 të dërguar nga S.A për H.S.; E-mail nga S.A. për B.Sh. i datës 04.07.2023; Vendim me numër

protokolli 2023/DSF/GJO/235 i datës 04.07.2023; E-mailin e datës 05.07.2023 nga S.A për H.S. me korrespondim prej faqe 1-3; E-mailin e datës 05.07.2023 nga S.A për S.Laë me korrespondim prej faqe 1-3; E-mailin e datës 05.07.2023 nga S.A për S.Laë me korrespondim prej faqe 1-2; E-mailin e datës 05.07.2023 nga S.A për S.Laë me korrespondim prej faqe 1-3; E-mailin e datës 05.07.2023 nga S.A për S.Laë me korrespondim prej faqe 1-4; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 20.07.2023; Përgjigje në ankesë e datës 27.07.2023; Akt emërim i S.A të datës 31.12.2012; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Zyrtar i Operimeve Ajrore për Helikopter (OI-H) i datës 25.09.2012; Delegimin i Inspektorit-Inspektor i Operimeve për Helikopter S.A. i datës 19.12.2018; E-mailin e datës 14.06.2023 nga S.S për H.S me korrespondim prej faqe 1-3; Lista e pagës së S.A; E-mailin e datës 24.06.2023 nga SH.S për S.S me korrespondim prej faqe 1-2; Tabelen Exel lidhur me kalkulimin e pagave për S.A për muajin maj 2023; Kërkesë për pagesë retroaktive/Formulari i të dhënave për listën e pagave të lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës për S.A lidhur me Ekzekutimin e Vendimit të KPMSHCK-së Nr.1247/2022 për kompenzimin e diferencës së pagës nga data 19.12.2018 deri më 30.05.2023; E-mailin e datës 04.05.2023 nga B.E për M.K etj. me korrespondim prej 1-14 faqe; E-mailin e datës 26.07.2023 nga B.E për K.M etj.; E-mail nga K.M. për S.S. i datës 24.07.2023; E-mail nga S.S. për K.M. i datës 24.07.2023; E-mailin e datës 03.07.2023 nga GAT për T.K me korrespondim prej 1-3 faqe; E-mailin e datës 07.06.2023 nga GAT për B.A etj. me korrespondim prej faqe 1-3; E-mailin e datës 16.06.2023 nga GAT për K.M me korrespondim prej faqe 1-2; E-mailin e datës 16.06.2023 nga GAT për M.A etj. me korrespondim prej faqe 1-3; E-mailin e datës 03.07.2023 nga GAT për K.M me korrespondim prej faqe 1-2; E-mailin e datës 03.07.2023 nga GAT për K.M me korrespondim prej faqe 1-4; E-mailin e datës 11.03.2021 nga S.E për S.S me korrespondim prej faqe 1-2; E-mailin e datës 15.03.2021 nga A.K për S.S me korrespondim prej faqe 1-3.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi që të përfundoi procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.918/2023 i datës 05.07.2023 të parashtruar nga ankuesi *sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesi Skender Ahmeti sipas Akt Emërimit të datës 01.01.2013 është i punësuar në pozitën "Zyrtar i Operimeve për Helikopter" në kuadër të Departamentit të Sigurisë së Fluturimeve në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës.

Ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka parashtruar ankesë me pretendimin ankimor kundër përgjigjes nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës të datës 14.06.2023 në lidhje me kompensimin e diferencës së pagës së tij, nga muaji Dhjetor 2018 deri Maj 2023 dhe rregullimin e Akt Emërimit.

Kolegji i Këshillit, gjatë shqyrtimit të ankesës së ankuesit, ka konstatuar Këshilli i Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 20.02.2023 me numër protokollit 1878/2023 ka nxjerr vendim lidhur me pretendimin ankimor për kompensim material të ankuesit Skender Ahmeti si dhe për rregullimin e Akt Emërimit, për të njëjtën Këshilli ka vendosur meritorisht. Ndërsa Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës me datë 15.05.2023 me numër Ref.27/2023 ka zbatuar vendimin e Këshillit.

Bazuar në këtë Kolegji konstaton se meqenëse Këshilli brenda periudhës dy vjeçare ka vendosur për ankesën e ankuesit lidhur me kompensimin material, atëherë ankesa e ankuesit rrjedhimisht është e konsumuar pasi që Këshilli ka vendos sipas Vendimit me numër A.nr.1247/2022 të datës 20.02.2023 me numër protokoll 1878/2023, atëherë Kolegji konstaton se janë përmbushur kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të iniciuar sipas ankesës së ankuesit komfor dispozitave të nenit 101 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *1. Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se: 1.1. gjatë më pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike*. Kolegji konstatoi që të përfundoj procedimi administrativ i filluar me ankesën A.nr.918/2023 të datës 05.07.2023 të parashtruar nga ankuesi

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe sipas nenit 101 paragrafit 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.918/2023

Çlirim Zeka

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit avokatit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës ;
- Udhëheqësit të Personelit në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës; dhe
- Arkivot të KPMSHCK-së.